



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 46

Prishtinë, më 04.07.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, S-2

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Njomza Emini, Vjosa Osmani, Luljeta Gutaj-Veselaj, Bislim Zogaj, Arben Gashi, Donika Kadaj-Bujupi, dhe Slobodan Petroviç.

Munguan: Xhavit Haliti (në udhëtim zyrtar), Valdete Bajrami, Time Kadrijaj dhe Kujtim Paçaku.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi, znj. Njomza Emini, kryetare e Komisionit.

Në mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Raportim i z. Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja e Komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen.

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Raportim i z. Hajredin Kuçi, ministër i Drejtësisë

Kryetarja e Komisionit, fillimisht i uroi mirëseardhje ministrit, duke e falënderuar për kohën e ndarë për raportim në Komision, lidhur me sistemin e drejtësisë dhe politikën kundër korrupsionit, si dhe për mandatin e EULEX-it.

Ministri Kuçi, falënderoi për ftesën dhe njëherazi kërkoi falje që nuk kishte mundur të marrë pjesë në mbledhjen e javës së kaluar, për shkak të një udhëtimi zyrtar që e kishte pasur në Shqipëri.

Lidhur me përmbushjen e reformave në sistemin e drejtësisë, tha se Qeveria e Republikës së Kosovës është përqendruar në krijimin e një infrastrukture të mirëfilltë ligjore, duke krijuar parakushte për një sistem funksional, të bazuar në tri parime thelbësore: pavarësinë, paanshmërinë dhe llogaridhënien e gjyqësorit.

Fillimisht, reformat janë përqendruar në kompletimin e infrastrukturës ligjore, përmes hartimit të 44 ligjeve, kryesisht në rrafshin penal, duke përfshirë edhe Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale.

Të dyja këto kode, janë hartuar në përputhje me direktivat ligjore të Bashkimit Evropian, në konsultim me KGJK-në dhe KPK-në, si dhe në bashkëpunim të ngushtë me partnerët tanë ndërkombëtarë.

Me Kodin e ri Penal, janë ashpërsuar dënimet, veçanërisht ndaj veprave të rënda penale.

Për përmirësimin e mëtutjeshëm të *funksionimit* dhe *llogaridhënies* së gjyqësorit, Ministria e Drejtësisë ka bërë plotësim-ndryshimin e Ligjit për KPK-në, Ligjit për KGJK-në, Ligjit për gjykatat dhe Ligjin për Prokurorinë e Shtetit (Pakoja e gjyqësorit).

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar, në çështjet gjyqësore dhe penale, ka marrë notë pozitive nga Raporti i Progresit dhe nga procesi i DPSA-së. Kërkesat për bashkëpunim nga jashtë ekzekutohen në kohë rekorde.

Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet gjyqësore dhe penale, ka marrë notë pozitive edhe nga Raporti i Progresit, edhe nga procesi i DPSA-së. Në këtë drejtim, kemi pasur 3 lloje të bashkëpunimit: e para ka qenë me shtetet përreth nesh, e dyta ka qenë me shtetet anëtare të BE-së dhe e treta me shtetet që kanë popullatë më të madhe të qytetarët tanë. Kërkesat për bashkëpunim nga jashtë ekzekutohen në kohë rekorde. Ministria e Drejtësisë, vazhdimisht është duke negociuar dhe finalizuar marrëveshje bilaterale. Dua të theksoj nënshkrimin e marrëveshjes model për bashkëpunimin juridik në çështje penale me Gjermaninë, që mbulon me një marrëveshje ofrimin e ndihmës së ndërsjellë juridike, ekstradimin, transferimin e personave të dënuar, luftën kundër terrorizmit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Lidhur me infrastrukturën profesionale, tha se me plotësim-ndryshimin e Ligjit për KPK-në, që nga janari 2016, ministri i Drejtësisë nuk është më anëtar i KPK-së dhe i KGJK-së. Gjithashtu, vlen të theksohet që tani, KGJK dhe KPK kanë pavarësi të plotë buxhetore, duke siguruar shqyrtimin e buxhetit drejtpërdrejt nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Përmes Pakos së Gjyqësorit, përpos adresimit të të gjeturave nga Raporti i Progresit, Ministria e Drejtësisë ka përmbushur edhe njërin prej rekomandimeve kyçe, të dala nga DPSA.

Përmirësimi i sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial është pasuar edhe me ngritjen e profesioneve të lira. Noterët, përmbauesit privatë dhe ndërmjetësuesit, gjithashtu, ua kanë lehtësuar punën gjykatave, të cilat tani kanë përgjegjësi të shtuar për zgjidhjen më të shpejtë të lëndëve të grumbulluara.

Tek infrastruktura fizike, gjithashtu, është punuar në sigurimin kushteve më të mira fizike të ndërtesave të gjykatave dhe prokurorive. Ndër të tjera, duhet të përmendet funksionalizimi i Burgut të Sigurisë së Lartë, si një ndër zhvillimet më të rëndësishme, sa i përket ekzekutimit efikas të sanksioneve penale dhe garantimit të kushteve më të mira për të burgosurit. Gjithashtu, është funksionalizuar Pallati i Drejtësisë, ku një pjesë e madhe e gjykatave dhe prokurorive janë transferuar dhe po kryejnë funksionet e tyre.

Me arritjet në rrafshin penal, reforma e sistemit të drejtësisë tani është duke u përqendruar më shumë në avancimin e fushës civile, duke synuar kurorëzimin e saj me një kod të mirëfilltë civil. Hallet e përditshme ligjore që qytetarët dhe bizneset, janë kryesisht të natyrës civile. Qartësia ligjore që arrihet me kodifikimin e fushës civile, kontribuon drejtpërdrejt në përmirësimin e mjedisit për të bërë biznes dhe në ngritjen e mirëqenies së qytetarëve tanë. Përfundimi i hartimit të Kodit Civil do të rezultojë edhe me kompletimin e arkitekturës së drejtësisë në tërësi.

Gjithashtu, më lejoni t'ju njoftoj rreth nismës së Qeverisë për rishikimin strategjik të sektorit të drejtësisë. Përkundër reformave të vazhdueshme, sistemi i drejtësisë ende përballlet me një sërë sfidash, qoftë funksionale apo edhe ligjore. Kjo nismë me prioritet e Ministrisë së Drejtësisë, synon adresimin e këtyre problemeve, duke vlerësuar funksionalitetin e sistemit të drejtësisë në tërësi.

Sa i përket kompletimit të kornizës ligjore për luftë të suksesshme kundër korrupsionit, ministri tha se arritjet e lartcekura në pavarësinë, paanshmërinë dhe llogaridhënien e sistemit të drejtësisë, përmes avancimit të infrastrukturës ligjore, profesionale dhe fizike, janë edhe parakusht për luftimin e vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Përveç reformave të lartpërmendura në sektorin e drejtësisë, sa i përket parakushteve ligjore, Republika e Kosovës tanimë ka një kornizë të konsoliduar të ligjeve, për t'i luftuar veprat penale që ndërlidhen me korrupsion. Kodi Penal ka reformuar plotësisht standardet dhe politikat ndëshkimore, duke i njohur të gjitha llojet e shkeljeve për përfitime pasurore.

Korniza ligjore që garanton luftim të korrupsionit, përveç Kodit Penal, është me rëndësi të ceket edhe Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, Ligji për përgjegjësinë penale të personave juridikë, si dhe Ligji për mbrojtjen e informatorëve.

Së fundmi, kemi bërë edhe plotësim-ndryshimin e një sërë ligjesh, që ndërlidhen me fushën kundër-korrupsion.

Për luftim të suksesshëm të korrupsionit, gjithashtu, është themeluar edhe Prokuroria Speciale, me mision të veçantë, për t'u marrë me rastet e profilit të lartë të korrupsionit.

Promovimi i transparencës përmes monitorimit të hapur, është një garanci edhe për mua që procedurat të zhvillohen në rregull, duke ngritur përgjegjësinë e sektorit publik gjatë menaxhimit të parash publike, duke ngritur llogaridhënien ndaj taksapaguesve të Republikës së Kosovës.

Përtej kornizës ligjore, gjithashtu është funksionalizuar Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar (AAPSK), me kapacitete të plota.

Lidhur me mandatin e ri të EULEX-it, duhet të sigurohet një tranzicion i lehtë i kompetencave nga EULEX-i, tek institucionet e Kosovës. Ministria e Drejtësisë, në shtator 2015, ka hartuar Planin strategjik për transferimin e kompetencave tek institucionet e Kosovës. Ky plan është ndarë me institucionet qendrore të Kosovës, si dhe me përfaqësuesit e Bashkimit Evropian. Si rrjedhojë, me qëllim të konkludimit të procesit të negociimit të çështjeve që ndërlidhen me mandatin e EULEX-it, dhe të ardhmen e këtij misioni, në muajt që lamë pas, janë zhvilluar një sërë takimesh në mes të përfaqësuesve të BE-së dhe institucioneve të Kosovës. Diskutimet janë zhvilluar në shumë nivele, derisa në nivelin më të lartë politik në Kosovë, atë të Presidentit, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit dhe Bashkimit Evropian, nga Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian, është arritur një dakordim për vazhdimin e mandatit të EULEX-it edhe për 2 vite me radhë, por me kompetenca më të limituara sesa në mandatin e kaluar.

Qëllimi kryesor për vazhdimin e mandatit të EULEX-it edhe për 2 vite, është për t'u siguruar që të mos krijohet zbrazëti ligjore dhe të sigurohet administrim i duhur i drejtësisë, veçanërisht duke pasur parasysh që për rastet në proces të bartjes tek institucionet vendore, është ligjërishit i pamundur dhe do të shkaktonte probleme ligjore dhe shkelje të drejtave të njeriut.

Kryetarja, tha se në mbledhjen e Komitetit Punues për Integrim Evropian, është diskutuar për të gjeturat e raportit të parë tremujor, për periudhën janar-mars 2016, mbi zbatimin e Programit kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit, në konkluzionet e këtij komiteti punues, shihet se Ministria e Drejtësisë duhet të hartojë disa projektligje.

A keni kapacitete të mjaftueshme profesionale administrative për të përfunduar me kohë këto projektligje dhe kur mendoni që ta procedoni në Kuvend, Projektligjin për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme?

Donika Kadaj- Bujupi, ia parashtroi disa pyetje ministrit:

1. Lidhur me çështjen e marrëveshjeve për ekstradim, thatë se janë të lidhura me disa vende të BE-së dhe disa vende të rajonit, a mund t'i listoni se me cilat vende janë lidhur dhe a janë marrëveshjet e publikuara, ku mund t'i shohim këto marrëveshje, sepse ka interesim për të ditur se si t'i qasen dhe ku mund t'i lexojnë këto marrëveshje?
2. Njëra prej përgjegjësive të ministrisë suaj është edhe mbështetja në përgatitjen e marrëveshjeve të Qeverisë, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, këtu po i referohem marrëveshjes së asociacionit, në të cilën është gjetur se ka pasur 23 shkelje, andaj cili ka qenë roli i ministrisë suaj në përgatitjen e kësaj marrëveshjeje, dhe rrjedhimisht, përgjegjësia për shkeljet që kanë ndodhur në këtë marrëveshje?
3. Kriteri kyç për liberalizim të vizave është lufta kundër korrupsionit, cilët kanë qenë hapat konkretë në zbatimin e ligjeve në fuqi dhe që do të fillonin me plotësimin e këtij kriteri, i cili po merr shumë kohë dhe pasojat veç po rriten?
4. Një ligj që Lëvizja Vetëvendosje, vazhdimisht e ka kërkuar, është Ligji antimafia, andaj pyetja është se në cilën fazë jeni dhe na informoni më tepër për të?

Vjosa Osmani, tha se pyetja e parë lidhet me Ligjin antimafia, të cilën e përmendi parafolësja. Ne si Komision, kemi bërë një monitorim të zbatimit të Ligjit për konfiskimin e pasurisë së paligjshme, në të cilin kemi gjetur shumë parregullsi. Pyetja është, a do të hartohet një ligj tërësisht i ri dhe kuptohet se nuk mund të quhet tani Ligji antimafia, ashtu njihet në zhargonin e përditshëm? Mirëpo, pak a shumë, do t'i përfshijë dispozitat që kanë të bëjnë me konfiskimin e pasurisë së paligjshme, por edhe çështje tjera, sepse kemi dëgjuar se diçka është duke u punuar në atë drejtim, por si deputetë do të ishte mirë që të njoftohemi në fazat e mëhershme, në mënyrë që kur të na vijnë ligjet, sidomos të tilla që shpesh po duhet t'i miratojmë në procedura të përshpejtuara, të kemi mundësi që edhe ne dhe stafi ynë, paraprakisht të përgatitemi më mirë, për të dhënë një kontribut që ligji të jetë më mirë i përgatitur dhe më i zbatueshëm.

Çështja e dytë, ka të bëjë me Kodin Penal. Presidenti i tanishëm ka paralajmëruar se duhet bërë ndryshime në Kodin Penal, sa e kam kuptuar nga deklaratimet e tij, që të kemi një infrastrukturë më të mirë ligjore për luftimin e krimit dhe korrupsionit. Sa është duke u bërë në koordinim me ministrinë tuaj dhe çka saktësisht mund të presim ne si legjislativ, megjithatë sa jeni ju duke u koordinuar për këtë çështje? Në raportin tuaj nuk po shoh që mungon diçka në Kodin Penal dhe që paska nevojë për një reformë aq të rëndësishme.

Në raportin me shkrim, ju e keni përmendur ndryshimin strategjik të sektorit të drejtësisë, mirëpo nuk na keni dhënë shumë informata se në cilat fusha, konkretisht, pritet të nënshkruhet. Ku mendoni se do të jenë sfidat më të mëdha në këtë proces? Nëse mund të na tregoni edhe disa detaje, në veçanti, nëse mendoni se në Kosovë duhet që më seriozisht të merren metodat alternative për zgjidhjen e kontesteve, siç janë arbitrazhi dhe ndërmjetësimi, kapacitet dhe interesimi, qoftë tek bizneset apo tek komuniteti juridik, për këto metoda, është ende i vogël, në mënyrë që të krijonte një efekt në uljen e barrës së madhe, që për momentin e kanë gjykatat. A kemi ndonjë strategji institucionale dhe a po mendohet që të merren shumë më seriozisht këto metoda alternative që së paku rajonin ta zëmë në zhvillimin e tyre?

Bislim Zogaj, lidhur me Ligjin për kundër korrupsionit mendon se ka shumë të meta, sepse është shumë transparent, sepse përveç Prokurorisë, të dhënat nuk është mirë t'i shohë çdo qytetar, kur çdo ditë nëpër portale të ndryshme jepen të dhëna nga më të ndryshme, që shpeshherë po kalojnë edhe në banalitet.

Kurse sa i përket EULEX-it, pyeti se a jep ai përgjegjësi para dikujt për punën e bërë, sepse kemi një përvojë që shumë gjykime që janë organizuar kanë dalë të paargumentuara, dhe deri më tani

askush nuk ka dhënë përgjegjësi, sepse është vepruar në mungesë të argumenteve dhe në fund nuk ka dalë asgjë.

Ministri Kuçi, lidhur me projektligjet që dalin nga MSA-ja, tha se ne kemi qenë të kujdesshëm, deri më tani dhe kemi krijuar grupe punuese për këtë çështje dhe ne nuk i shfrytëzojmë kapacitetet vetëm të Ministrisë së Drejtësisë, por ekspertizën e profesorëve të ndryshëm universitarë, gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe asnjë projektligj nuk e procedojmë në Kuvend, pa e marrë vlerësimin nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial, si dhe pa e marrë pëlqimin nga Zyra e BE-së. Gjithmonë kemi pasur parasysh, që ligjet të jenë sipas kriterëve të BE-së, si dhe të jenë funksionale për vendin tonë.

Sa i përket marrëveshjeve për ekstradim, tha se kemi 3 lloje të respektimit të marrëveshjeve për ekstradim: e para ka të bëjë me nënshkrimin e marrëveshjeve me shtetet veç e veç, e dyta me reciprocitet, me disa shtete që kemi partneritet, dhe e treta, janë disa marrëveshje që pranohen në formë të suksesimit edhe në periudhat e mëhershme.

Kemi marrëveshje të shkëlqyera me të gjitha vendet përreth nesh dhe me të gjitha shtetet e BE-së, përjashtimisht me 5 shtetet që nuk na kanë njohur, si dhe kemi marrëveshje të veçanta me SHBA-të.

Asnjë qytetar i Republikës së Kosovës nuk mund të ekstradohet, nëse nuk ka një marrëveshje paraprake. Marrëveshjet, pasi nënshkruhen nga ministri, shkojnë për ratifikim te Presidenti i Republikës dhe Ministria e Jashtme i publikon në Gazetën zyrtare.

Lidhur me marrëveshjen e asociacionit, tha se ne nuk e kemi pasur dhe as nuk e kemi asnjë kompetencë aty dhe nuk kemi qenë pjesë e saj.

Kurse, sa i përket luftës së korrupsionit dhe Ligjit antimafia, në mandatin tim, herën e parë ju e dini se kemi hartuar një ligj që është quajtur Ligji për kompetenca të zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale dhe kemi tentuar të jetë funksional. Pra, ne, kur i përgatisim ligjet i kemi parasysh figurat publike, por edhe qytetarin e rëndomtë, që atë mund ta tangojë.

Barra e provës ka mbetur ende tek Prokuroria. Ne kemi bërë koncept-dokumentin dhe e kemi dërguar për pëlqim në Zyrën e BE-së dhe në Qeveri. Tani, barra e provës do të mbetet tek i pandehuri, është një shkallë më avancuese se që ka qenë. Unë besoj se prapë do ta quajmë Ligji për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale. Ju e dini se me Kodin Penal të ri, kemi dhënë mundësinë për sekuestrimin e pasurisë dhe pezullimin për çdo gjë, që në fazën e hetimeve. Ligjin antimafia, së shpejti do ta sjellim në Kuvend dhe jemi duke e bërë në koordinim të plotë edhe me shtetet anëtare të BE-së. Pra, jam i kujdesshëm që të japim mundësi për luftimin e dukurive negative dhe respektimin e të drejtave të individëve.

Sa i përket çështjes së Kodit Penal, është dhënë një iniciativë dhe e kam dërguar një letër në Komisionin për Legjislacion, Presidencë, EULEX, në Ambasadën Amerikane, Këshillin Prokurorial dhe institucione tjera, si dhe kam kërkuar t'i shikojmë mundësitë apo hendeqet në Kodin Penal. Zyra e Presidentit, me siguri do t'i japë vërejtjet e veta dhe sugjerimet, mirëpo esenca e Kodit Penal mbetet 99% e njëjtë. Po ashtu, kam lutur Këshillin Prokurorial dhe atë gjyqësor, me një letër qarkore, t'i pyes të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët se gjatë zbatimit në praktikë, a ka pasur ndonjë pengesë për ata? Jam i bindur që brenda këtij viti do ta bëjmë një amendamentim të tillë.

Sa i përket rishikimit të sektorit të drejtësisë, e kemi përgatitur një draft, një projekt serioz, prej 50 faqesh dhe e kemi dërguar te partnerët tanë ndërkombëtarë, që ta bëjnë rishikimin ligjor dhe institucional. Ju e dini se kemi institucione që në momentet e caktuara, mund të kenë konflikt kompetencash. Një shembull konkret, ne i kemi 6 institucione që e bëjnë luftimin e korrupsionit. Mendoj se duhet ta bëjmë një hierarki dhe sistem, që të dihet se kush është dhe ku është adresa. Pra, ka ardhur koha që në Kosovë të ketë një adresë të luftimit të korrupsionit.

Kam kërkuar nga USAID-i dhe kam premtimin e plotë që do ta dërgojnë një kompani, që do ta bëjë rishikimin e plotë të tij, do të jetë i ngjashëm me sektorin e sigurisë, kur e incizojnë gjendjen dhe do të vijnë me propozimet e tyre.

Lidhur me çështjen e dënimeve alternative, tha se mbi bazën juridike dhe institucionale kemi qëndruar dhe qëndrojmë mirë dhe në funksionalitet do të bëjmë më shumë. Në mandatin tim,

kemi themeluar noterinë, ndërmjetësimin, përmbaruesit privatë, administratorët dhe arbitrazhin, të cilat janë funksionale në Kosovë.

Tani kam bërë një marrëveshje, që ndërmjetësuesit të gjejnë vend nëpër gjykata, sepse njerëzit tanë nëse i shohin ndërmjetësuesit që qëndrojnë në objektet e gjykatave, dallon prej shtëpive private, sepse gjykata ia rrit besimin dhe ky është model që e kam parë në shtetet tjera.

Jam i kënaqur me punën e bërë në noteri dhe përmbaruesit privatë do ta bëjmë monitorimin e tyre, ndërsa ata që kanë bërë shkelje, do t'u merret licenca.

Sa i përket të dhënave në Ligjin kundër korrupsionit, nëse dëshirojmë të kemi transparencë, duhet të jemi të kujdesshëm me të dhënat personale, dhe nëse dëshirojmë që të kemi siguri, duhet të jemi të kujdesshëm me privatësinë e njerëzve. Këtu duket se nuk është ruajtur balanca si duhet. Pra, kur i plotësoni formularët, aty shkruan konfidenciale dhe them se sektori i hetuesisë, Prokuroria i kanë qasjet 24 orë. Të tjerat, për hir të qytetarëve, duhet t'i diskutoni me Agjencinë Kundër Korrupsionit, që ta gjejnë një metodë më të mirë edhe të praktikave të tjera ndërkombëtare.

Kurse, sa i përket përgjegjësisë së EULEX-it, ata llogaridhënien e kanë në BE, por brenda tyre ka mekanizma që njerëzit tanë mund t'i shfrytëzojnë, mekanizmat për të drejtat e njeriut dhe mekanizmat e tjerë për korrektim. Nuk hyj në atë se a kanë qenë apo nuk kanë qenë efektivë, por mjetet juridike duhet të shfrytëzohen brenda sistemit juridik. Ata kanë bashkëpunim dhe partneritet bilateral, por për llogaridhënie nuk iu përgjigjen institucioneve tona.

Vjosa Osmani, i tha ministrit se i vjen mirë që te Ligji antimafia, e keni marrë parasysht rekomandimin numër një të këtij Komisioni, që barra e provave të kalojë prej Prokurorisë tek i pandehuri. Kemi pasur shumë dyshime se a do të merret parasysht, sepse është barrë tepër e rëndë dhe është mjaft strikte dhe shumë pak shtete në botë e bëjnë një gjë të tillë.

Arben Gashi, diskutoi lidhur me 2 çështje.

1. Ligji antimafia mendon se është emërtuar gabim dhe duhet të mbetet strikt, si Ligji për konfiskimin e pasurisë të përfutur me vepër penale apo të paligjshme, nuk është me rëndësi titulli, por është me rëndësi përmbajtja.

2. Ai i tha ministrit se edhe ju e keni shqetësim çështjen e barrës së provës. Është e vërtetë se këtu, barra e provës në këto raste kalohet te i padituri, por problemi kryesor është a ka hapësirë për keqpërdorim, mund të akuzohet dikush, pastaj ai duhet të vërtetohet se është i pafajshëm, kurse principi bazë i drejtësisë, ai që të akuzon, ai vërteton se je fajtor, kurse këtu ndryshohet principi i drejtësisë.

Kurse, sa i përket Agjencisë Kundër Korrupsionit, rregullohet me ligj të veçantë dhe i jep llogari Kuvendit dhe nuk është në autoritetin e Ministrisë së Drejtësisë. Shqetësimet e mia, janë së pari prej emërimit të Agjencisë, sepse ata nuk merren me kundërkorrupsion, por ata merren me verifikim dhe krahasim të pasurisë. Kundërkorrupsioni është çështje e Prokurorisë dhe institucioneve të specializuara, që kanë kapacitete ligjore.

Kurse, për çështjen e privatësisë, tha se është çështje mjaft e ndejshme dhe mendon se është në fushën e Kuvendit.

Bislim Zogaj, sa i përket konfiskimit të pasurisë, mendon se është herët t'i konfiskohet pasuria personit në momentin që dyshohet, sepse konsideron se po dëmtohen sidomos bizneset, p.sh. nëse në momentin që dyshohet një firmë dhe i konfiskohet pasuria dhe procedurat e ngadalshme, shkojnë dy vjet apo tre dhe në fund del i pafajshëm, në fund falimenton ai biznes. Mendoj se është më mirë të shikohet mundësia që një herë t'i vërtetohet fajësia, e pastaj të konfiskohet pasuria.

Ministri Kuçi, u përgjigj duke thënë se në fjalorin tim asnjëherë nuk e përdori ligjin antimafia, por është fjalor më tepër i mediave që e kanë marrë prej Shqipërisë, kurse ata prej Italisë, mendoj se prapë do ta ketë emërtimin siç e kam quajtur gjithmonë: Ligji për kompetencat e zgjeruara dhe konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale.

E përmendet më shumë të drejtë barrën e provës. Edhe herën e kaluar është bërë shumë zhurmë lidhur me këtë, por ju them se asnjëherë nuk kam bërë dhe nuk bëj ligje, duke parë fotografitë e njerëzve në Kosovë ose duke mos i parë. Për mua, ligjet i kanë standardet e BE-së dhe funksionalitetin në Kosovë.

Tek ne, parim kushtetues është parimi i pafajësisë. Çdokush është i pafajshëm, derisa të vërtetohet e kundërta, pra do të jem i kujdesshëm të barra e provës dhe mendoj se personat publikë duhet t'i shtimë në këtë, ashtu si rekomandohet me kriteret e BE-së, do ta procedoj në Kuvend.

Sa përket sekuestrimit të pasurisë së të dyshuarit, sekuestrohet jo e tërë pasuria që e ka individ, por vetëm ajo pasuri që është fituar me vepër penale. E di që do ta bëjmë balancën e plotë, që asnjë individ mos t'i shkelet e drejta e tij.

Vjosa Osmani, theksoi se në raportin e Komisionit Evropian për liberalizimin e vizave, është thënë se edhe dy kriteret kanë mbetur pa u plotësuar, para se të miratohet rekomandimi për liberalizim edhe në Këshillin e Ministrave dhe në Parlamentin Evropian.

Fatkeqësisht, të gjithë po flasin për një kriter, atë të demarkacionit me Malin e Zi, por askush nuk po flet për kriterin e luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, sepse gjithnjë po thuhet se kjo varet nga Kuvendi, që nuk është e vërtetë, sepse kjo varet edhe nga Qeveria dhe institucionet tjera.

Pra, nuk e kemi vetëm demarkacionin, por e kemi edhe luftimin e krimit dhe korrupsionit si kriter, pra konkretisht, çka po kërkohet saktësisht dhe çka përmban konkretisht ky kriter, që Qeveria e Kosovës, bashkë me institucionet, të plotësojë, para se të kemi një vendim për liberalizim?

Ministri Kuçi, në përgjigjen e tij, tha se edhe ato 8 kriteret që kanë qenë dhe tani që kanë mbetur dy, nuk kanë të bëjnë asgjë me Ministrinë e Drejtësisë, sepse nuk ka të bëjë më me ligje, por më shumë ka të bëjë me rezultate konkrete nga Policia, Prokuroria dhe gjykatat e Kosovës.

Kryetarja falënderoi ministrin për përgjigjen e ftesës dhe për raportimin dhe vazhdoi me pikat tjera të rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinion ligjor, lidhur me përputhshmërinë e këtij projektligji me legjislacionin e BE-së. Pas shqyrtimit dhe analizimit të projektligjit, së bashku me amendamentet e Komisionit funksional, konstatojmë se projektligji, së bashku me amendamentet, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, përkatësisht nuk është e rregulluar me Acquis të BE-së dhe mund të rekomandohet për miratim në Kuvend.

Lidhur me këtë projektligj, hapi debatin,

Vjosa Osmani, lidhur me këtë projektligj, tha se kishte një koment, përkundër faktit që BE-ja e ka lënë një hapësirë të madhe, që shtetet anëtare veç apo shtetet që aspirojnë BE-në, të jenë pjesë e saj, ta vënë këtë çështje, varësisht prej rrethanave të tyre juridike, kulturore, politike dhe sociale. Situata e tanishme në Kosovë, është jashtëzakonisht e vështirë, sa i përket respektimit dhe zbatimit të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, të cilat ne ua kemi dhënë atyre me ligje. Pra, po bëhen së paku 8 vite pas pavarësisë, që vazhdimisht miratojmë ligje. Sot, një person i cili është në karrocë dhe nuk mund të lëvizë dhe e fiton një vend pune në Qeverinë e Kosovës, si të shkojë në punë ai person nga shtëpia e tij, deri në ndërtesën e Qeverisë ose Kuvendit, në rrugët e Prishtinës, praktikisht është e pamundur. Në ndërtesën e Qeverisë, nuk ka tualete që mund të

futen personat me aftësi të kufizuara dhe këto janë vështirësi elementare, ndërsa 10 ose 20% nuk i implementojmë ato që ua premtujmë me ligj.

Ne, si Kuvend i Kosovës, duhet të mendojmë përtej ligjit, përtej letrës, sepse e kuptoj që kompetencat janë të ndara, dhe si Kuvend, duhet të mendojmë si t'i bëjmë bashkë të gjitha përpjekjet, në mënyrë që atyre, sado pak, t'ua lehtësojmë jetën, sepse ata i kanë disa aftësi të kufizuara, por disa i kanë të zhvilluara më shumë sesa ne.

Kryetarja, tha se pajtohem plotësisht, sepse sa kam qenë anëtare e Komisionit për Shëndetësi, kam qenë në grupin punues, dhe në hulumtimet që i ka bërë NDI dhe KDI, i kemi parë se në çfarë gjendje janë dhe kjo është shqetësuese. Mendoj se ne duhet ta kemi një projektligj gjithëpërfshirës të personave me aftësi të kufizuara dhe jo t'i japim privilegje vetëm një kategorie.

Ne, nëse jemi dakord, duhet të iniciojmë një ligj gjithëpërfshirës për personat me aftësi të kufizuara.

Arben Gashi, pajtohet për krejt çka u tha, por konsideroi se është jashtë domenit të Komisionit.

Vjosa Osmani, tha se të drejtat themelore të njeriut janë parime themelore të Acquis komunitare dhe ne po flasim për qasje, për të drejtën në punësim dhe të drejtën në lëvizje, që janë të garantuara me Kushtetutë dhe janë të drejta në kontekstin evropian, si dhe që bëjnë pjesë në parimet e Acquis komunitare. Pra, na lejon absolutisht të merremi me këtë fushë.

Arben Gashi, tha se më pëlqen pasioni, me të cilin po diskutojmë, por me intereson se në kuadër të lirive dhe të drejtave të njeriut, cili nen i këtij ligji që po e diskutojmë, ka probleme dhe po më intereson ta di çka, dhe nëse ka ndokund, ku janë shkelur të drejtat e njeriut, ndërsa nëse ka diçka që mungon, atëherë unë jam absolutisht dakord me ju. Për mendimin tim, nuk patëm pikë të qartë të diskutimit dhe mbetet jashtë pikës së rendit të ditës dhe objektivit të Komisionit.

Vjosa Osmani, nuk di si të shprehem për punën e pasionit dhe emocionalitetit. Juve mund t'iu duket shumë pasionuese mënyra si unë i komentoj, pra është çështje e shprehjes. Tek e fundit, janë qytetarët ata që na vlerësojnë. Sa i përket neneve që duhet të diskutohen, nuk jemi këtu për të folur për nene specifike, por atë çka thashë deri tani, është se përtej letrave që po i prodhojmë, duhet të mendojmë për zbatimin, sepse është në mandatin e Kuvendit, që ta mbikëqyrë zbatimin e këtyre ligjeve. Pra, në zbatimin e këtyre ligjeve janë vërejtur mangësi të shumta. Ne po iu japim të drejta kësaj kategorie të njerëzve, në punësim dhe në fusha të tjera, por ata nuk po mund t'i realizojnë këto të drejta. Po ashtu, ne duhet të mendojmë si ta bëjmë legjislacionin më efikas dhe më të zbatueshëm.

Fola në aspektin e përgjithshëm, se këto ligje nuk po zbatohen, kurse sa i përket ligjit aktual, nuk ka probleme konkrete, sepse BE-ja iu ka lënë hapësirë të mjaftueshme shteteve, individualisht, për ta rregulluar këtë çështje.

Arben Gashi, tha se krejt çka u tha deri më tani, mbetet mbi bazën e retorikës dhe jam dakord që Qeveria nuk e ka bërë punën si duhet për sigurimin e kushteve për këtë kategori. Kjo çështje mbetet këtu, por mendoj se problemi është te konfiguracioni gjeografik, për shkak të kodrave të mëdha, por gjithsesi duhet dhe mund bëhet më shumë, por pasi jemi te pika e rendit të ditës, mendova që ka diçka konkrete, por nuk ka dhe është në rregull.

Vjosa Osmani, nuk e di çka duhet më tepër të konkretizoj, sesa shembujt që i dhashë, për të kuptuar që ende ka probleme për mënyrën sesi rregullohet kjo fushë. Pra, të vlerësojmë sa herë deputetëve të Kuvendit të Kosovës u thuhet kjo është retorikë, ajo është retorikë, ne për 4 vite ishte dashur të mbyllim gojën dhe për të mos folur kurrë. Thjesht, jam duke e kryer punën time dhe jam duke iu përgjigjur problemeve të shumta, për te cilat më shkruan një kategori e madhe e qytetarëve. Po ashtu, mos të harrojmë se sipas statistikave të HENDIKOS-it dhe organizatave

tjera, del se 10% e qytetarëve janë me aftësi të kufizuara. Dhe, nëse kur flasim për të drejtat e tyre na duket retorikë, është çështje e vlerësimit tuaj.

Arben Gashi, i tha parafolëses se mënyra sesi po e trajton çështjen, është retorikë.

Luljeta Gutaj-Veselaj, tha se për projektligjin në fjalë, mendoj se Komisioni përkatës që kaluar projektligji dhe grupi punues i ka marrë parasysh të gjitha vërejtjet, që edhe ne i diskutuam, është shqetësuese, por ne duhet krijuar kushte dhe të fillojmë që nga kopshtet, shkollat fillore, në fakultete dhe pastaj në vendet e punës, sepse ata fillimisht duhet të aftësohen, riaftësohen, shkollohen e pastaj të punësohen. Sa i përket inicimit të një projektligji gjithëpërfshirës, tha se vazhdimisht në fushën e edukimit dhe arsimimit flitet dhe shkruhet për gjithëpërfshirje, por nuk realizohet në programet edukativo- arsimore.

Kryetarja, pas votimit, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Rekomandim

Projektligjit nr. 05/L-078 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019, për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, me amendamentet e Komisionit funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së, dhe si i tillë, mund të procedohet për miratim në Kuvend.

4. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, kryetarja njoftoi se Komisionin se me GIZ-in gjerman, është në konsultime për organizimin e një vizite studimore në Bruksel dhe në Berlin dhe pyeti anëtarët se a mendojnë ta realizojnë vizitën gjatë muajit korrik apo pas pushimeve në shtator, si dhe të propozojnë se me kë mendojnë të takohen gjatë kësaj vizite. Në fund, anëtarët u pajtuan që vizita të realizohet në shtator, pas pushimeve.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetare e Komisionit,

Njomza Emini